

Përshëndetje të gjithëve.

Në rradhë të parë dua t'ju falenderoj për këtë traditë të krijuar tashmë në çdo fillim viti, ku ulemi bashkarisht dhe bëjmë një analizë të asaj çfare kemi bërë mirë vitin që shkoi, çfarë duhet të përmirësojmë dhe çfarë sfidash na presin në vijim.

Prioritet i Qeverisë Shqiptare është krijimi i një klime të favorshme për biznesin, të cilin e konsideron motor të zhvillimit ekonomik të vendit dhe padyshim roli i Doganës Shqiptare është mjaft i rëndësishëm dhe kyç në këtë klimë.

Çfarë kemi bërë ne si administratë përgjatë vitit që shkoi dhe cilat janë sfidat që kemi përpara?

Një ndër objektivat tonë më të rëndësishëm **është përmirësimi i shërbimit për qytetarët dhe biznesin.**

Në këtë aspekt, kemi punuar intensivisht në drejtim të:

- **Shërbimeve të shpejta për të gjitha autorizimet që administrata doganore ofron në përputhje me ligjin.**

Kemi ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe nëpër Degët Doganore Pikat Informuese për Qytetarët/Bizneset (Info Point)

Në kuadër të derregullimit objektivi ynë përgjatë këtij viti është në përfshirjen e pjesës më të madhe të autorizimeve në Platformën E-Albania duke ndryshuar komplet rikonceptimin e ndërveprimit aktual për shërbimet, ku elementi kryesor është jo vetëm aplikimi online nga ana e subjektit, por dhe vendimmarrja totalisht në mënyrë elektronike nga administrata doganore, pra që dhe autorizimi i Drejtorisë së

Përgjithshme të Doganave apo Degëve Doganore të jetë i nënshkruar elektronikisht.

Sfidë mbetet implementimi i një “Dogane pa letër” jo vetëm për shkresat ndërmjet strukturave tona, por ndërmjet biznesit dhe doganës **për procedura dhe vendime transparente dhe në një kohë sa më të shkurtër.**

- **Kemi ndryshuar mënyrën e vlerësimit të deklaratave doganore nëpërmjet një sistemi qëndror.**

Ky sistem i aplikuar përgjatë vitit që lamë pas ka ndikuar drejtpërsëdrejti në shkëputjen e kontakteve të doganierëve vlerësues me subjektet, duke shmangur familiarizimin e tyre, duke shmangur ndikimet në vlerësimin e praktikave, si dhe duke ndikuar në unifikimin e rivlerësimit për rastet kur refuzohet transaksioni. Gjithashtu një element shumë i rëndësishëm që ka ardhur është pikërisht ndarja e vlerësimit dhe kryerja e tij vetëm pas ushtrimit të kontrollit të mallit, që aktualisht funksionon pranë Degëve Doganore **duke krijuar një ndarje të qartë të përgjegjësisë lidhur me deklaratën doganore.**

Kjo qasje e re u shoqërua dhe me rikonceptimin e të gjithë procedurave të vlerësimit, ku një element kyç është procedura e ndjekur nga ana e doganierit vlerësues, e cila është në cdo moment e gjurmueshme, një element mjaft i rëndësishëm për administratën doganore dhe ju.

Objektivi ynë përgjatë këtij viti është standartizimi i proceseve të vlerësimit më tej **duke rritur cilësinë e analizës dhe argumentave në vlerësim, të cilat në jo pak raste kanë qënë objekt i shqetësimit tuaj.**

Ne si administratë synojmë një qasje të drejtë ndaj biznesit, duke synuar vetëm profesionalizëm, transparencë dhe vendimmarrje të

duhur vetëm në bazë të kuadrit ligjor dhe ekspertizës teknike të stafit të administratës sonë.

Sfidë mbetet përmirësimi i sistemeve informatike dhe teknologjike, shkëmbimet në kohë reale të informacioneve ndërmjet strukturave brenda vendit dhe homologe, trajnimi i stafit, trajnimi i agjentëve doganore që jo në pak raste janë një faktor kyç në marrëdhënien mes nesh, marrja e vendimeve teknike për raste specifike të cilat duhet të gjejnë një trajtim të unifikuar për të gjithë sistemin.

Ndërkohë një element shumë i rëndësishëm që është dhe në vëmendjen tuaj lidhet me aplikimin **e çmimeve referuese nga ana e administratës doganore.**

Dua të ndaj me ju vetëm disa shifra që tregojnë qartë qasjen e qeverisë ndaj biznesit për frymën e bashkëpunimit, duke besuar tek njëri-tjetri, por pa dyshim duke ushtruar kompetencat dhe ngritur sistemet e kontorllit dhe monitorimit për të shmangur abuzimet e mundshme.

Kështu nëse në vitin **2013 përqindja e artikujve** që rivlerësoheshin me çmime referuese nga administrata doganore ishte në masën **19.07 %** e numrit total të artikujve kjo shifër në **vitin 2018 është reduktuar në 11.38 % e totalit të artikujve të zhdoganuar.**

Po të elimojmë këtu artikujt që vlerësohen me bursë dhe zhdoganimet e makinave të përdorua, **këto shifra janë nga 15.51 % ne vitin 2013 në vetëm 5.49 % të artikujve.**

Pavarësisht të sa më sipër, vlerësojmë shqetësimin tuaj lidhur me përditësimin e të dhënave të disponueshme.

Një element shumë i rëndësishëm dhe që është ngritur si shqetësim dhe është kërkuar bashkërendimi me administratën **janë konsultimet me biznesin lidhur me burimet e përditësimit.**

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave është duke menduar propozimin pranë Ministrisë së Financave për ndryshimin e organizimit të funksionimit të Komitetit Ad-Hoc, duke propozuar krijimin e një Bordi me përfaqësues të biznesit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke krijuar jo vetëm burime shtesë **por duke siguruar dhe trajtim të shpejtë të problematikave të vlerësimit.**

- Kemi rritur numrin e praktikave të deklaratave doganore me kontroll aposterior (kanali blu) ose pa kontroll (Kanali jeshil) duke reduktuar kohën e përpunimit të deklaratave doganore.

Ulja e nivelit të kontrollit fizik është një ndër objektivat e Administratës Doganore dhe një nga objektivat kryesore të DARM-së për vitin 2019 me **qëllim krijimin e lehtësirave për biznesin dhe targetim më të saktë dhe rritje të efektivitet në kontrollet e ushtruara.**

Përgjatë **vitit 2018 u fut për herë të parë kanali blu (aposterior), i cili zë rreth 7.25 % të gjithë deklaratave.** Ndërkohë **kemi rritur deklaratat në kanal jeshil duke zgjeruar bazën e kësaj kategorie nga 5.58 % në 8.68% të totalit të deklaratave.**

Rishikimi i kriterëve të Kanalit Blu dhe Jeshil me qëllim zgjerimin e veprimit të tyre, janë ndër objektivat tona kryesore për këtë vit. Synimi i administratës doganore është kalimi nga **15.8 % në minimumi 30 % për vitin 2019.**

Ky ri-konfigurim ka sjellë rezultatet e para në uljen e kohës së procesimit të deklaratave doganore. **Sipas të dhënave statistikore deklaratat e përpunuara brenda 30 minutash janë rritur nga 26 % në vitin 2017 në 37 % në vitin 2018**

Sfidë mbetet rritja e mëtejshme e numrit të deklaratave në këtë interval kohor, dhe kjo kryhet **nëpërmjet një sistemi adekuat rrisht, si dhe nëpërmjet modernizimit të mëtejshëm të shërbimit.**

Nuk mund të lë pa përmendur këtu procesin e nënshkrimit elektronik, i cili tashmë është përfshirë dhe për punonjësit doganorë, në cdo ndërhyrje të tyre në sistem, si dhe projektin më të ri të DEMP-it (Deklarimit Elektronik të Magazinimit të Përkohshëm), i **cili do të përmbyllë për herë të parë në sistemin doganor lidhjen e çdo tranziti brenda territorit doganor me deklaratat, qoftë ato të importit apo eksportit.**

Ky është një element kyç që përmbyll procesin e doganës paperless dhe mundëson çlirimin e mallrave në mënyrë automatike nga sistemi pas kryerjes së veprimve verifikuese dhe vlerësuese.

Gjej rastin të falenderoj për mbështetjen maksimale të gjithë biznesin dhe agjentët doganorë, të cilët janë përfshirë në këtë proces që është mjaft i rëndësishëm duke kërkuar ndjesë për ndonjë vonesë apo mosfunksionim sistemi përgjatë kësaj periudhe.

Por a është bërë mjaftueshëm në bashkëpunimin midis nesh. Besoj se ndajmë të njëjtin mendim po të them që janë bërë mjaft hapa përpara, por kemi shumë rrugë për të bërë drejt këtij bashkëpunimi.

Çdo ndryshim nga ajo çfarë jemi mësuar të bëjmë çdo ditë, pa dyshim është një sfidë dhe vështirësi, në radhë të parë për ne si administratë.

Mund të ketë dhe mangësi dhe ne jemi të hapur për çdo sugjerim tuajin. Jemi të bindur që nëpërmjet bashkëpunimit, sistemit, dhe mekanizmave të monitorimit të punës së çdo punonjësi **do t'ia dalim**.